



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr.Dok.202201466/4

Tiranë ___/___/2023

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave, për garantimin e të drejtës për arsim dhe programe zhvillimi për fëmijën E. K., me aftësi të kufizuara, në interesin më të lartë të tij

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

TIRANË

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
KORÇË

KORÇË

Për dijeni:

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE "STILIANO BANDILLI"

BERAT

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP), në mbështetje të pikës 1, të nenit 60, të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit" të ndryshuar (ligji nr.8454/1999), mori në shqyrtim ankesën e shtetasit Dritan Kurti. Kjo ankesë adreson problematikën e mungesës së një mësuesi ndihmës për fëmijën e tij me incialet E.K., 17 vjeç, person me aftësi të kufizuara (PAK), i cili ndjek studimet në vitin e parë në shkollën e mesme profesionale "Stiliano Bandilli", të qytetit të Beratit. Arsimi dhe formimi profesional është një fushë edukimi, që kombinon arsimin me praktikën profesionale, dhe i pajis individët me njohuri e shprehje të veçanta, si dhe me kompetenca të gjera që kërkohen për t'u punësuar në një profesion të caktuar dhe për t'u integruar në tregun e punës.¹

¹ Pika 3 e nenit 4, të ligjit 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e shqipërisë".

Pika 1 e nenit 20, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, pohon se fëmija ka të drejtë të gëzojë një nivel jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Gjithashtu, në pikën 1 të nenit 18, të të njëjtit ligj thuhet se, fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm, qoftë ai edhe profesional, me qëllim përmirësimin e njohurive, shprehive, aftësive, kompetencave dhe/ose kualifikimeve për arsye personale, shoqërore dhe/ose profesionale.

Ligj nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe specifikisht neni 5 i këtij ligji “garanton të drejtën për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar”. Në nenin 6 të po këtij ligji theksohet se “interesi i nxënësit është parësor” dhe “nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj”.

Në Rregulloren “Për funksionimin e institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 1 të nenit 80 të Kreut XIV, i cili dedikohet arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar, përcaktohet se, Zyra Vendore Arsimore (ZVA) ngre Komisionin Multidisiplinor të përbërë nga një mjek pediatër (kur është e mundur, mjek pediatër zhvillimi), një psikolog, një punonjës social, një mësues (kur është e mundur, mësues i kualifikuar për arsimin e specializuar) dhe drejtuesi i Njesisë së Shërbimit Psiko-Social, duke përcaktuar në këtë mënyrë punën e çdo strukture, përfshirë dhe prindërit, në lidhje me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Komisioni me kërkesën e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të fëmijës ose të drejtorit të IAsë, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore të fëmijës dhe ecurinë e tij dhe “personi që ushtron përgjegjësinë prindërore i paraqet Komisionit në ZVA raportin vlerësues të fëmijës së tij të kryer nga komisioni mjekësor, kur fëmija është vlerësuar nga ky komision mjekësor.” Është pikërisht Komisioni në ZVA i cili “njofton personin që ushtron përgjegjësinë prindërore për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës” dhe “bazuar në rekomandimin e Komisionit Multidisiplinor cakton mësuesin ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuar sipas nevojave individuale të tyre”.

Të drejtat fëmijës janë të garantuara edhe në Kartën Sociale Evropiane², ku vëmendje e veçantë u kushtohet personave dhe grupeve më të cenueshëm. Është e rëndësishme të ofrojmë ose të nxisim, sipas nevojave, trajnimin teknik dhe profesional të të gjithë personave, përfshirë dhe personat me aftësi ndryshe, në këshillim me organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve dhe për t'ju ofruar këtyre personave (PAK) lehtësira që lejojnë apo nxisin pranimin në arsimin e lartë teknik dhe universitar, të bazuar vetëm në aftësitë individuale³.

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454/1999, institucioni i AP-së, pasi mori dijeni për problematikën nga ankesa, filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes për fëmijën me inicialet E.K. (PAK), duke kërkuar mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të tij për një arsimim të denjë dhe cilësor. Nëpërmjet shkresës me nr.K5/D5-2 Prot., datë 12.12.2022, ju drejtuam shkollës së mesme profesionale “Stiliano Bandilli”, Berat. Në kthim përgjigjen e saj, shkolla na bën me dije se, për shkak të nevojave për mësues ndihmës, në fillim të vitit shkollor 2022-2023, ka bërë kërkesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) duke prezantuar nevojat për mësues ndihmës. Gjithashtu, bazuar në Udhëzimin nr.13, datë 13.04.2022 “Për mësues ndihmës dhe ngritjen e funksionimit e komisionit për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit profesional”, drejtoria e shkollës ka ngritur Komisionin e Aftësisë së Kufizuar dhe i është drejtuar me kërkesë zyrtare ZVAP-së Berat, për vendosjen e një mësuesi ndihmës në këtë institucion arsimor. Pavarësisht kësaj, vendosja e një mësuesi ndihmës, nuk është mundur për shkak të mungesës në organikën e miratuar nga MFE-ja⁴, ç’ka passjellë cënimin e të drejtës për arsim cilësor, një e drejtë e mohuar.

Nga analiza e informacionit të dërguar nga ky institucion edukues, dhe nga ankesa e të atit të fëmijës, me inicialet E.K., konstatojmë që i mituri, nxënës në vitin e parë, frekuenton në mënyrë të rregullt procesin mësimor pranë kësaj shkolle, por që prej muajt shtator 2022, nuk gëzon të drejtën për të pasur mësues ndihmës. Identifikimi i nevojave për plotësimin e vendeve të punës, me mësues ndihmës, në institucionet edukuese të arsimit parauniversitar, nga të katërta Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar në RSH, është i domosdoshëm me qëllim planifikimin paraprak në fillim të çdo viti arsimor.

Mungesa e mësuesit mbështetës, përbën një problematikë serioze në drejtim të garantimit të së drejtës së fëmijës për t’u arsimuar, si dhe të ofrimit ndaj tij të planeve mësimore të veçanta të edukimit. Mësuesi ndihmës është mjaft i rëndësishëm në procesin e të nxënës për fëmijën nxënës me aftësi të kufizuar, i cili në bashkëpunim me mësuesin e klasës/mësuesin lëndor, psikologun,

² Karta Sociale Evropiane është nënshkruar nga vendi ynë më 21.09.1998 dhe është ratifikuar me 14.12.2002.

³ Pika 1 e nenit 10 e Kartës Sociale Evropiane.

⁴ Shkresa nr.266 Prot., datë 16.12.2022 e institucionit shkolla e mesme profesionale “Stiliano Bandilli”, Berat.

punonjësin social të shkollës dhe prindin, harton dhe zbaton Programin Edukativ Individual (PEI), të miratura nga Komisioni i Shkollës për nxënësit me aftësi të kufizuara⁵.

Në këtë kuptim, vazhdimësia e punës në ofrimin e shërbimeve edukative dhe integruese, kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale, për të bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën me institucionet e tjera jashtë shkollës (p.sh. me Zyrën Vendore Arsimore të qytetit, prindërit, qendrat për fëmijë me aftësi të kufizuara etj.), në zbatim të legjislacionit të ri të shërbimeve sociale⁶, si dhe bazuar në plotësimin e nevojave apo minimizimin e ndikimit të pasojave negative të dukurive sociale të fëmijët me aftësi të kufizuara. Ky bashkëpunim dhe bashkërendim është i rëndësishëm, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së punës, për fuqizimin e sistemit të mbrojtjes sociale, për identifikimin, vlerësimin, përfshirjen dhe integrimin e kësaj kategorie në jetën shoqërore, në funksion të zbatimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës. Në këtë frymë, është e rëndësishme, që nxënësve me aftësi të kufizuara t'u sigurohen shërbime rehabilituese dhe mësues ndihmës, të cilët procedojnë nëpërmjet programeve të specializuara dhe të personalizuar për secilin nxënës me aftësi të kufizuara⁷.

Sistemi i arsimit dhe formimit profesional vepron kah parimit të gjithëpërfshirjes, duke ofruar mundësi arsimimi dhe formimi profesional për të gjithë, pa asnjë diskriminim. Gjithashtu, ky sistem ka për mision zhvillimin e kompetencave personale e profesionale të nevojshme, si dhe shprehi e kompetenca të tjera të diversifikuara, që pasqyrojnë preferencat dhe nevojat e veçanta të punëdhënësve për të siguruar mirëqenien sociale dhe zhvillimin ekonomik⁸.

Institucioni ynë ka rekomanduar në disa raste, marrjen e masave, për konsolidimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të punës të të gjithë strukturave të mbrojtjes së fëmijës, të cilat ofrojnë shërbime publike, për të mundësuar integrimin e përfituesve me diagnoza të lehta të shëndetit mendor në shkolla normale dhe kurse profesionale, me qëllim punësimin e tyre. Vetëm kështu ata mund të realizojnë një jetesë të pavaruar, duke krijuar raporte të vazhdueshme dhe të herëpashershme me shkollat, bizneset, profesionistët e lirë, etj.

Shteti duhet të prioritetizojë rolin parësor të familjes në mbrojtjen e fëmijëve dhe të sigurojë kujdesin dhe mbështetjen e duhur në mënyrë që çdo vendim të

⁵ Shkronja c, e pikës 1, të kreut 2, të udhëzimit nr.26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar” të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

⁶ Ligji nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

⁷ Pika 2 e nenit 65, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

⁸ Shkronja a, e nenit 3, të ligjit nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në R e publikën e Shqipërisë”.

merret mbi bazën e interesave më të larta të fëmijës⁹. Zbatimi i Agjendës 2030 “Për Zhvillimin e Qëndrueshëm”¹⁰ është thelbësor, për sigurimin e mirëqënies dhe gëzimit të të gjithë të drejtave për fëmijët. Angazhimi kryesor që “Asnjë të mos mbetet pas” përbën parimin kyç të të gjitha Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Ky rekomandim është në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, të institucionit të Avokatit të Popullit në procesin e zbatimit dhe monitorimit të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara. Konkretisht objektivi 4.5 i kësaj Agjende thekson rëndësinë e sigurimit të një arsimit gjithëpërfshirës dhe me cilësi të barabartë me qëllim promovimin e mundësive të të mësuarit përgjatë gjithë jetës, duke eliminuar pabarazitë gjinore në arsim dhe sigurimin e një qasjeje të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe **aftësimin profesional** për personat në nevojë, përfshirë **personat me aftësi të kufizuara**.

Referuar rasteve kur përfshihen fëmijë është e rëndësishme që institucionet përgjegjëse të ndërmarrin veprime konkrete për të garantuar të drejtën e arsimimit të fëmijës, sidomos të atyre me gjendje fizike dhe mendore të veçanta apo dhe të fëmijëve, familjet e të cilëve ndodhen në situata të vështira sociale, ekonomike. Gjithashtu, sjellim në vëmendje, se e drejta e çdo fëmije për t’u arsimuar, siç e parasheh neni 18, i ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ku fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, është një e drejtë themelore e patjetërsueshme.

Edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka vënë në dukje rëndësinë e parimeve themelore të universalitetit dhe mosdiskriminimit në ushtrimin e së drejtës për arsim, të cilat përmenden në shumë tekste ndërkombëtare.

Për më tepër, mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara përfshin një detyrim për shtetet që të sigurojnë "akomodim të arsyeshëm" për t'u lejuar personave me aftësi të kufizuar mundësinë për të realizuar plotësisht të drejtat e tyre dhe një dështim për ta bërë këtë përbën diskriminim (Çam kundër Turqisë, 2016, 65-67; Enver Şahin kundër Turqisë, 2018, 60; G.L. kundër Italisë, 2020, 62). Gjykata ka konsideruar se “akomodimi i arsyeshëm” mund të marrë forma të ndryshme, qoftë fizike apo jofizike, arsimore apo organizative, për sa i përket aksesit nga pikëpamja arkitekturore të ndërtesave shkollore, trajnimit të mësuesve, përshtatjes kurrikulare apo objekteve të përshtatshme; (Çam kundër

⁹ Ansambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 26.7.2019 “Status of the Convention of the Rights of the Child-Report of the Secretary General”, 68 session.

¹⁰ Kombet e Bashkuara (2015). Të transformojmë botën tonë: Axhenda për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030. Marrë nga <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication>, e aksesueshme në dhjetor 2015.

Turqisë, 2016, 66; Enver Şahin kundër Turqisë, 2018, 61; G.L. kundër Italisë, 2020, 63)

Në këtë kuptim, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454/1999, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në fushën e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe, në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve, Avokati i Popullit,

R E K O M A N D O N:

- Marrjen e masave për vënien në dispozicion të një mësuesi ndihmës në shkollën e mesme profesionale “Stiliano Bandilli”, për të mbështetur dhe asistuar nxënësin me inicialet E.K.
- Marrjen e masave nga Komisioni Multidisiplinar pranë Zyrës Vendore Arsimore Berat, për vlerësimin e nevojave të fëmijës me inicialet E.K dhe hartimin e Planit Edukativ të Individualizuar të objektivave specifike të nivelit të zhvillimit të fëmijës.
- Planifikimin paraprak në fillim të çdo viti shkollor lidhur me nevojën për mësues ndihmës në sistemin arsimor parauniversitar.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454/1999, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t'i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditë nga data e dërgimit.

Për, sa më sipër, lutemi në vijim të na informoni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi. Ky rekomandim është pjesë e raportimit periodik të institucionit të Avokatit të Popullit pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit nr.49/2017, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Mekanizmi për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, si dhe do të vlerësohet edhe nga grupi i ngritur për këtë qëllim nga Kryetari i Kuvendit.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit, në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve.

K O M I S I O N E R

Olta ALIAJ

